



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

Datë: 03.06.2025
Numër Protokolli: 3820/2025

A.nr.688/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.688/2025 të datës 22.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, S.M., kundër organit të punësimit: Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.688/2025, e datës 22.04.2025, e parashtruara nga ankuesja S.M., ashtu që, **detyrohet** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të shqyrtoj kërkesën e datës 13.02.2025, të parashtruar nga ankuesja S.M., dhe të nxjerr akt administrativ në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, S.M. (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 18.04.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill, është pranuar më datë 22.04.2025, dhe numër protokolli 2607/2025, e regjistruar nën shenjën A.nr.688/2025, për shkak të mos kompensimit të orëve të kujdestarisë të punës gjatë natës dhe punës jashtë orarit zyrtar, për muajin janar-dhjetor 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 07.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.05.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja është e punësuar në Komunën e Lipjanit, dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër Nr.01-101/03-37386, mbanë pozitën e punës “Zyrtare për Shërbime Sociale 2”, në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja më datë 13.02.2025 ka parashtruar Kërkesë me numër protokollit Nr.01-120/02-7144, tek Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Lipjanit, duke kërkuar kompensimin e punës së natës dhe punës jashtë orarit të punës, për vitin 2024.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të moskompensimit të orëve të kujdestarisë së punës, punës gjatë natës dhe fundjavave në rastet urgjente që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, viktimave të dhunës dhe grupeve të cënueshme; strehimit urgjent, si dhe intervenimit për të gjitha rastet sipas kompetencës territoriale në institucionet e Kosovës. Kërkon nga Këshilli që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ta detyrojë organin përkatës të punësimit që të ekzekutojë kompensimin financiar sipas kërkesës së datës 13.02.2025.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitatat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën me numër protokollit Nr.01-120/02-71444 të datës 13.02.2025, të parashtruar nga ankuesja, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Kështu që thënë si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e datës 22.04.2025, në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj Kërkesën me numër protokollit Nr.01-120/02-71444 të datës 13.02.2025, dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitatat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.688/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, S.M.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.